

Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 773/2004, datë 7 prill 2004 për përdorimin e veprimeve procedurale nga Komisioni, sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit të KE-së (tekst kuptimi i të cilit ka lidhje me ZEE)

Gazeta Zyrtare L 123, 27/04/2004 fq. 0018-0024

Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 773/2004, datë 7 prill 2004 në lidhje me përdorimin e veprimeve procedurale nga Komisioni, sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit të KE-së (tekst kuptimi i të cilit ka lidhje me ZEE)

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian,

Duke pasur parasysh Marrëveshjen mbi Zonën Ekonomike Europiane,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1 / 2003, datë 16 dhjetorit 2002 për zbatimin e rregullave të konkurrencës, të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit [1] dhe në veçanti në nenin 33 të tij;

Pas këshillimeve të Komitetit Këshillimor mbi Praktikën Kufizuese dhe Pozitat Dominuese,

Duke pasur parasysh se:

1. Rregullorja (KE) nr. 1/2003 autorizon Komisionin të rregullojë disa aspekte të veprimeve procedurale për zbatimin e neneve 81 dhe 82 të Traktatit. Është e nevojshme të përcaktohen rregulla në lidhje me fillimin e veprimeve procedurale nga Komisioni, po kështu edhe për shqyrtimin e ankimeve dhe dëgjimit të palëve në shqyrtim.
2. Në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 1/2003, gjykatat kombëtare janë të detyruara të shmangin marrjen e vendimeve, të cilat do të mund të bien në kundërshtim me vendimet e parashikuara nga Komisioni në të njëjtin rast. Në përputhje me nenin 11 pika 6 të kësaj rregulloreje, autoriteteve kombëtare të konkurrencës u hiqet kompetenca menjëherë kur Komisioni Europian ka nisur veprimet procedurale për miratimin e një vendimi, sipas kapitullit III të Rregullores (KE) nr. 1/2003. Në këtë kontekst është e rëndësishme që gjykatat dhe autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare të jenë të informuar për fillimin e veprimeve procedurale nga Komisioni. Komisioni duhet gjithashtu të jetë i aftë për të bërë publike vendimet e tij për të filluar veprimet procedurale.
3. Përpara mbledhjes së deklarimeve gojore të personave fizikë ose juridikë, të cilët figurojnë të jenë të pyetur, Komisioni duhet t'i informojë këta persona mbi bazën juridike të marrëveshjes dhe natyrës së saj të vullnetshme. Personat e intervistuar duhet gjithashtu të jenë informuar për qëllimin e intervistës dhe të çdo regjistrimi që mund të jetë bërë. Me qëllim për të përforcuar saktësinë e deklaratave, personave të pyetur duhet t'u jetë dhënë një mundësi për të korrigjuar deklaratimet e regjistruara. Kur informacionet e përfutuara nga deklaratimet gojore janë këmbyer në përputhje me nenin 12 të Rregullores (KE) nr. 1/2003, ky informacion duhet të jetë përdorur vetëm si një provë për të vënë sanksione mbi personat fizikë, ku kushtet e vendosura në nenin e mësipërm janë plotësuar.
4. Në vijim të nenit 23, pika 1 gërma (d) të Rregullores (KE) nr. 1/2003, gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjeve dhe shoqatave të ndërmarrjeve, të cilat dështojnë të korrigjojnë brenda afatit kohor të fiksuar nga Komisioni, një përgjigje të pasaktë, të paplotë ose jonormale, të dhënë nga një anëtar i personelit të tyre për pyetjet e bëra gjatë inspektimit. Për pasojë është e nevojshme t'i jepet ndërmarrjes në fjalë procesverbali i çdo shpjegimi të dhënë, dhe të hartohet një procedurë që i lejon ndërmarrjes të shtojë çdo ndreqje, ndryshim ose plotësim të shpjegimeve të dhëna nga një anëtar i personelit, i cili nuk është ose nuk ishte i autorizuar të jepte shpjegime në emër të ndërmarrjes.

5. Ankimet janë një burim informacioni thelbësor për të zbuluar shkeljen e rregullave të konkurrencës. Është e rëndësishme të përcaktohen procedura të qarta dhe efikase për trajtimin e ankimeve të depozituara pranë Komisionit.
6. Me qëllim që të jetë e pranueshme për qëllimet e nenit 7 të Rregullores (KE) nr. 1/2003, ankimi duhet të përmbajë disa informacione të caktuara.
7. Me qëllim për të ndihmuar ankimuesit që të paraqesin faktet e nevojshme te Komisioni, duhet dorëzuar një formular. Paraqitja e informacionit të regjistruar në atë formë do të ishte një kusht për një ankim për të qenë e trajtuar e tillë siç është cilësuar në nenin 7 të Rregullores (KE) nr. 1/2003.
8. Personave fizikë ose juridikë, të cilët kanë vendosur të depozitojnë një ankim, duhet t'u jepet mundësia që të jenë të shoqëruar nga afër me veprimet procedurale e angazhuara nga Komisioni me qëllim për të konstatuar shkeljen. Megjithatë, ata nuk duhet të kenë të drejtën e hyrjes në sekretet e biznesit ose të tjera informacione konfidenciale që u përkasin palëve të tjera, të përfshira në veprimet procedurale.
9. Ankimuesit duhet të kenë mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre, nëse Komisioni çmon që motivet e dhëna në vazhdim të ankimit janë të pamjaftueshme. Kur Komisioni refuzon një ankim me motivin që ky i fundit është duke u trajtuar ose tashmë është trajtuar nga autoriteti i konkurrencës së një Shtetit Anëtar, ai duhet të informojë ankimuesin për identitetin e këtij autoriteti.
10. Për të respektuar të drejtat e mbrojtjes së ndërmarrjeve, Komisioni duhet t'u japë palëve të përfshira të drejtën e dëgjimit, para marrjes së një vendimi.
11. Duhet parashikuar edhe një rregullim ligjor për dëgjimin e personave, të cilët nuk kanë depozituar ankim në kuptim të nenit 7 të Rregullores (KE) nr. 1/2003 dhe që nuk janë palë të cilëve u janë adresuar ankimet, por që, megjithatë, tregojnë një interes të mjaftueshëm. Shoqatat e konsumatorëve, të cilët bëjnë kërkesë për t'u dëgjuar, përgjithësisht duhet të konsiderohen sikur të kenë interes të mjaftueshëm kur veprimet procedurale përkatëse të prodhimeve dhe shërbimeve të përdorura nga konsumatorët përfundimtarë, ose kur mallrat dhe shërbimet e përdorura janë si ndërhyrës të drejtpërdrejtë në prodhim ose si lëndë të para në prodhime, ose shërbime të tilla. Kur ai e gjykon të nevojshme për veprimet procedurale, Komisioni gjithashtu duhet të ketë mundësinë të ftojë të tretët të shprehin pikëpamjet e tyre me shkrim, dhe të jenë të pranishëm në dëgjimin e fjalëve të palëve, të cilave u është adresuar një njoftim i ankimeve. Ai në raste të ngjashme duhet t'i ftojë këta persona të shprehin pikëpamjet e tyre në shtjellim të këtij dëgjimi.
12. Për të përmirësuar efikasitetin e dëgjimeve, relatori duhet të ketë kompetencën për të lejuar palët përkatëse, ankimuesit, të tretët e ftuar në dëgjim, personeli i Komisionit dhe autoritetet e Shteteve Anëtare të drejtojnë pyetje gjatë dëgjimit.
13. Kur lejon të drejtën e vëzhgimit të dosjes, Komisioni duhet të garantojë mbrojtjen e sekreteve të biznesit dhe të tjera informacione konfidenciale. Kategoria e "informacioneve të tjera konfidenciale" nënkupton informacione të ndryshme nga sekretet e biznesit, të cilat mund të konsiderohen si konfidenciale, përhapja e të cilave do të sillte dëmtimin serioz të një ndërmarrjeje ose një personi. Komisioni duhet të jetë në gjendje t'u kërkojë ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve, të cilat i paraqesin ose i kanë paraqitur, dokumente ose deklarata për të identifikuar informacione konfidenciale.
14. Kur përhapja e sekreteve të biznesit ose të tjera informacione konfidenciale janë të nevojshme për të provuar një shkelje, Komisioni duhet të vlerësojë, për çdo dokument, nëse nevoja e përhapjes mbart dëmin që mund të rezultojë nga kjo përhapje.
15. Për arsye të sigurisë juridike, përcaktohet një afat minimal kohor për njoftime të ndryshme të parashikuara në këtë rregullore.

16. Kjo rregullore zëvendëson Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 2842/98 e 22 dhjetorit 1998 për dëgjimin palëve në disa veprime procedurale sipas neneve 85 dhe 86 të Traktatit të KE-së [2], e cila për pasojë duhet shfuqizuar.
17. Kjo rregullore njëson rregullat procedurale në sektorin e transportit me rregullat e përgjithshme procedurale në të gjithë sektorët. Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 2843/98 e 22 dhjetorit 1998 në formë, përmbajtje dhe të tjera hollësi të kërkesave dhe njoftimeve të parashikuara nga Rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 1017/68, (KEE) nr. 4056/86, dhe (KEE) nr. 3975/87, mbi zbatimin e rregullave për konkurrencën në sektorin e transportit [3], duhet të shfuqizohet.
18. Rregullorja (KE) nr. 1/2003 heq sistemin e njoftimit dhe autorizimit. Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 3385/94 e 21 dhjetorit 1994 në formë, përmbajtje dhe të tjera hollësi të kërkesave dhe njoftimeve të parashikuara nga Rregullorja e Këshillit nr. 17 [4], duhet të shfuqizohet,

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

KREU I QËLLIMI

Neni 1

Fusha e zbatimit dhe qëllimi

Kjo rregullore është e zbatueshme për veprimet procedurale të caktuara nga Komisioni, në zbatim të neneve 81 dhe 82 të Traktatit të KE-së.

KREU II FILLIMI I VEPRIMEVE PROCEDURALE

Neni 2

Fillimi i veprimeve procedurale

1. Komisioni mund të vendosë të nisë veprime procedurale me qëllim përshtatjen e një vendimi, sipas Kreut III të Rregullores (KE) nr. 1/2003 në çdo çast, por jo më vonë nga data në të cilën bëhet vlerësimi paraprak sipas nenit 9 pika 1 të rregullores në fjalë ose deklaratës së ankimeve, ose data në të cilën është botuar njoftimi, sipas nenit 27 pika 4 të rregullores, cilado qoftë e para.
2. Komisioni mund të bëjë publike, në mënyrën më të përshtatshme, fillimin e veprimeve procedurale. Përpara se të kryejë këtë veprim, ai njofton palët e interesuara.
3. Komisioni mund të ushtrojë kompetencat e tij të hetimit, sipas Kapitullit V të Rregullores (KE) nr. 1/2003, përpara fillimit të veprimeve procedurale.
4. Komisioni mund të refuzojë një ankim, sipas nenit 7 të Rregullores (KE) nr. 1/2003, pa filluar veprimet procedurale.

KREU III
SHQYRTIMET NGA KOMISIONI

Neni 3

Kompetenca e marrjes së deklaratave

1. Kur Komisioni pyet një person me pëlqimin e tij, në përputhje me nenin 19 të Rregullores (KE) nr. 1/2003, ai tregon, në fillim të pyetësorit, bazat ligjore dhe qëllimin e seancës dhe vë në dukje karakterin e saj vullnetar. Ai njofton gjithashtu personin e pyetur për qëllimin e tij për mbajtjen e procesverbalit.
2. Pyetësi mund të zhvillohet me të gjitha mjetet e mundshme të komunikimit, përfshirë këtu telefonin dhe rrugën elektronike.
3. Komisioni mund të regjistrojë deklaratat e bëra nga personat e pyetur në çdo formë. Një kopje e çdo regjistrimi vihet në dispozicion të personit të pyetur për miratim. Kur është e nevojshme, Komisioni cakton një afat kohor, brenda të cilit personi i pyetur mund t'i komunikojë ndonjë korrigjim që mund t'i bëhet deklaratës.

Neni 4

Pyetjet verbale gjatë inspektimeve

1. Kur, sipas nenit 20, pika 2, germa (e), të Rregullores (KE) nr. 1/2003, inspektorët ose personat shoqërues të autorizuar nga Komisioni, kërkojnë shpjegime përfaqësuesve ose anëtarëve të personelit të një ndërmarrjeje ose një shoqate ndërmarrjesh, shpjegimet e dhëna mund të regjistrohen në çdo formë.
2. Një kopje e çdo regjistrimi të kryer sipas të paragrafit 1 i vihet në dispozicion, pas inspektimit, ndërmarrjeve ose shoqatave të ndërmarrjeve të përfshira në inspektim.
3. Në rastet ku një shpjegim është kërkuar nga një anëtar i personelit të ndërmarrjes ose të një shoqate ndërmarrjesh, i cili nuk është ose nuk ka qënë i autorizuar nga ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjes të jepte shpjegime në emër të ndërmarrjes ose një shoqate ndërmarrjesh, Komisioni cakton një afat kohor, brenda të cilit ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjes mund të komunikojë me Komisionin për çdo korrigjim, ndryshim ose plotësim të shpjegimeve të dhëna nga ky anëtar i personelit. Korrigjimi, ndryshimi ose plotësimi i shtohet shpjegimeve të regjistruara sipas paragrafit 1.

KREU IV
TRAJTIMI I ANKIMEVE

Neni 5

Pranueshmëria e ankimeve

1. Personat fizikë ose juridikë paraqesin një interes legjitim për të patur të drejtën që të depozitojnë ankim për qëllimet e nenit 7 të Rregullores (KE) nr. 1/2003. Ankime të tilla përmbajnë informacionin e kërkuar nga formulari C, sikurse është caktuar në Shtojcë. Komisioni mund të vendosë ta përjashtojë këtë detyrim për një pjesë të informacioneve, përfshirë këtu dhe dokumentet e kërkuara nga formulari C.
2. Tri kopje të shtypura dhe nëse është e mundur edhe një kopje elektronike e ankimit i paraqiten Komisionit. Ankimuesi, po ashtu, paraqet një version jokonfidencial të ankimit të tij, nëse pretendohet konfidencialiteti i një pjese të ankimit.
3. Ankimet paraqiten në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian.

Neni 6

Pjesëmarrja e ankimuesve në veprimet procedurale

1. Kur Komisioni lëshon një deklaratë të kundërshtimeve, në lidhje me një çështje për të cilën ai ka marrë një ankim, ai i jep ankimuesit një kopje të versionit jokonfidencial të deklaratës së kundërshtimeve dhe i vendos një afat, brenda të cilit ai lejohet t'i bëjë të njohura me shkrim pikëpamjet e tij.
2. Kur e lejojnë rrethanat, Komisioni mundet t'u japë ankimuesve mundësinë t'i shprehin pikëpamjet e tyre në seancën e dëgjimit të palëve, ndaj të cilave është lëshuar deklarata e kundërshtimeve, në qoftë se ankimuesit e kërkojnë diçka të tillë në komentet e tyre me shkrim.

Neni 7

Refuzimi i ankimit

1. Kur Komisioni konsideron që mbi bazën e informacioneve, të cilat ai i disponon, nuk ekzistojnë motive të mjaftueshme për të dhënë vazhdimin e një ankimi, ai njofton ankimuesin për arsyet e tij dhe cakton një afat, brenda të cilit ankimuesi të bëjë të njohur pikëpamjen e tij me shkrim. Komisioni nuk është i detyruar të marrë në konsideratë vërejtjet me shkrim të dhëna pas mbarimit të këtij afati.
2. Nëse ankimuesi bën të njohur pikëpamjet e tij brenda afatit kohor të caktuar nga Komisioni, dhe vërejtjet me shkrim të ankimuesit nuk çojnë në një vlerësim të ndryshëm të ankimit, Komisioni refuzon me vendim ankimin.
3. Nëse ankimuesi nuk bën të njohur pikëpamjen e tij brenda afatit kohor të caktuar nga Komisioni, ankimi konsiderohet si i tërhequr.

Neni 8

E drejta për t'u informuar

1. Kur Komisioni ka njoftuar ankimuesin për qëllimin e tij për refuzimin e një ankimi sipas nenit 7 pika 1, ankimuesi mund të kërkojë të njihet me dokumentet mbi të cilat Komisioni bazon dispozitat e tij vlerësuese. Për këtë qëllim ankimuesi, megjithatë, nuk ka të drejtë të njihet me sekretet e biznesit dhe informacionet e tjera konfidenciale që i përkasin palëve të tjera të përfshira në veprimet procedurale.
2. Dokumentet, për të cilat ankimuesi ka pasur të drejtë njohjeje në kontekstin e veprimeve procedurale të drejtuara nga Komisioni sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit, mund të përdoren vetëm nga ankimuesi për qëllimet e veprimeve ligjore ose administrative për zbatimin e këtyre dispozitave të traktatit.

Neni 9

Refuzimi i ankimeve sipas nenit 13 të Rregullores (KE) nr. 1/2003

Kur Komisioni refuzon një ankim sipas nenit 13 të Rregullores (KE) nr. 1/2003, ai informon pa pasur vonesa, ankimuesin e Autoritetit Kombëtar të Konkurrencës, i cili po përballet ose është përballur tashmë me rastin.

KREU V

USHTRIMI I SË DREJTËS PËR T'U DËGJUAR

Neni 10

Deklarata e kundërshtimeve dhe përgjigja

1. Komisioni duhet njofton me shkrim palët e interesuara për kundërshtimet e ngritura kundrejt tyre. Deklarata e kundërshtimeve i njoftohet secilës prej tyre.
2. Komisioni , kur i njofton deklaratën e kundërshtimeve palëve të interesuara, vendos një afat kohor brenda të cilit këto palë mund ta njoftojnë atë me shkrim për pikëpamjet e tyre. Komisioni nuk është i detyruar të marrë në konsideratë deklaratat me shkrim të marra pas mbarimit të afatit kohor.
3. Palët mund, në deklaratat e tyre me shkrim, të paraqesin të gjitha faktet që ata njohin, të cilat kanë lidhje me mbrojtjen e tyre kundrejt kundërshtimeve të ngritura nga Komisioni. Ata bashkëlidhin çdo dokument përkatës si provë e fakteve të paraqitura. Ata sigurojnë një letër origjinale, ashtu si dhe një kopje elektronike, ose kur nuk sigurojnë një kopje elektronike, 28 kopje letër, të deklaratave të tyre dhe të dokumenteve bashkëlidhur me të. Ata mund të propozojnë, që Komisioni të dëgjojë personat të cilët mund të konfirmojnë faktet e paraqitura në deklaratat e tyre.

Neni 11

E drejta për t'u dëgjuar

1. Komisioni i jep palëve, të cilave u është adresuar deklarata e kundërshtimeve, mundësinë për t'u dëgjuar përpara këshillimit me Komitetin Këshillimor të referuar në nenin 14 pika 1 të Rregullores (KE) nr. 1/2003.
2. Komisioni, në vendimet e tij, shqyrton vetëm kundërshtimet në përputhje me të cilat palët e referuara në paragrafin 1, kanë qenë në gjendje të komentojnë.

Neni 12

E drejta për seancë dëgjimore

Komisioni i jep palëve, të cilave u është adresuar deklarata e kundërshtimeve, mundësinë për të zhvilluar argumentet e tyre në një seancë dëgjimore, nëse ata kërkojnë diçka të tillë në deklaratat e tyre me shkrim.

Neni 13

Dëgjimi i personave të tjerë

1. Nëse personat fizikë ose juridikë, të tjerë nga ata të referuar në nenin 5 dhe 11, bëjnë kërkesë për t'u dëgjuar dhe tregojnë një interes të mjaftueshëm, Komisioni i informon ata me shkrim për natyrën dhe tematikën e procedurës dhe duhet të vendosi një afat kohor, brenda të cilit ata mund të bëjnë të njohur pikëpamjet e tyre me shkrim.
2. Komisioni mund, kur është e përshtatshme, të ftojë personat e referuar në paragrafin 1 për të zhvilluar argumentet e tyre në seancën dëgjimore të palëve, të cilëve u është adresuar deklarata e kundërshtimeve, nëse personat e referuar në paragrafin 1 kërkojnë diçka të tillë në komentet e tyre me shkrim.
3. Komisioni mund të ftojë çdo person tjetër për të shprehur pikëpamjet e tij me shkrim, dhe të marrë pjesë në seancën dëgjimore të palëve, të cilëve u është adresuar deklarata e kundërshtimeve. Gjithashtu Komisioni mund të ftojë persona të tillë për të shprehur pikëpamjet e tyre në seancën dëgjimore.

Neni 14

Drejtimi i seancës dëgjimore

1. Seancat dëgjimore drejtohen nga një zyrtar dëgjimor në pavarësi të plotë.
2. Komisioni fton personat për t'u dëgjuar të marrin pjesë në seancën dëgjimore në datën e caktuar nga ai.
3. Komisioni fton autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare për të marrë pjesë në seancën dëgjimore. Gjithashtu mund të ftojë zyrtarë dhe nëpunës civilë të autoriteteve të tjera të Shteteve Anëtare.
4. Personat e ftuar për të marrë pjesë ose paraqiten personalisht, ose përfaqësohen nga përfaqësues ligjorë, ose përfaqësues të autorizuar nga kushtetuta e tyre. Ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve mund gjithashtu të përfaqësohen nga një agjent i autorizuar, siç duhet, nga stafi i tyre i përhershëm.
5. Personat e dëgjuar nga Komisioni mund të ndihmohen nga avokatët e tyre ose persona të tjerë të kualifikuar të pranuar nga zyrtari dëgjimor.
6. Seancat dëgjimore nuk janë publike. Secili person mund të dëgjohej veçmas ose në prani të personave të tjerë të ftuar për të marrë pjesë, duke pasur parasysh interesin legjitim të ndërmarrjes në mbrojtje të sekreteve të tyre të biznesit dhe informacioneve të tjera konfidenciale.
7. Zyrtari dëgjimor mund të lejojë palët ndaj të cilave është adresuar deklarata e kundërshtimeve, ankimuesit, personat e tjerë të ftuar në seancë, shërbimet e komisionit dhe autoritetet e Shteteve Anëtare për të bërë pyetje gjatë seancës.
8. Deklaratat e mbajtura nga secili person i dëgjuar regjistrohen. Sipas kërkesës, regjistrimi i seancës duhet të bëhet i vlefshëm për personat të cilët marrin pjesë në seancë. Duhet pasur parasysh interesi legjitim i palëvënë mbrojtjen e sekreteve të tyre të biznesit dhe çdo informacion tjetër konfidencial.

KREU VI E DREJTA E NJOHJES ME DOKUMENTET DHE PËRDORIMIT TË INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

Neni 15

1. Nëse kërkohet, Komisioni garanton të drejtën e njohjes me dokumentet palëve të cilëve u është adresuar deklarata e kundërshtimeve. E drejta e njohjes garantohet pas njoftimit të deklaratës së kundërshtimeve.
2. E drejta e njohjes me dokumentet nuk shtrihet tek sekretet e biznesit, tek të tjera informacione konfidenciale dhe dokumente të brendshme të Komisionit ose të autoriteteve të konkurrencës së Shteteve Anëtare. E drejta e njohjes me dokumentet, gjithashtu, nuk shtrihet në korrespondencën ndërmjet Komisionit dhe autoriteteve të konkurrencës të Shteteve Anëtare ose ndërmjet këtyre të fundit, kur një korrespondencë e tillë përmbahet në një dokument të Komisionit.
3. Asgjë në rregullore nuk ndalon Komisionin nga zbulimi dhe përdorimi i informacionit të nevojshëm për të provuar një shkelje të neneve 81 dhe 82 të traktatit.
4. Dokumentet e marra nëpërmjet të drejtës për t'u njohur me dokumentet sipas këtij neni, përdoren vetëm për qëllimet e veprimeve juridike ose administrative për zbatimin e neneve 81 dhe 82 të traktatit.

Neni 16

Identifikimi dhe mbrojtja e informacionit konfidencial

1. Informacioni, duke përfshirë dokumentet, nuk komunikohet ose të bëhet i arritshëm nga Komisioni, për aq sa ai përmban sekrete biznesi ose informacion tjetër konfidencial të çdo personi.

2. Çdo person i cili bën të njohur pikëpamjet e veta sipas nenit 6 pika 1, nenit 7 pika 1, nenit 10 pika 2 dhe nenit 13 pikat 1 dhe 3 ose në vijim i dorëzon Komisionit informacion të mëtejshëm, në vazhdim të së njëjtës procedurë, identifikon qartësisht çdo material, i cili konsiderohet të jetë konfidencial, duke dhënë arsye dhe duke siguruar një version të ndarë jokonfidencial nga data e vendosur nga Komisioni për të bërë pikëpamjet e tij të ditura.
3. Pa cenuar paragrafin 2 të këtij neni, Komisioni mund t'i kërkojë ndërmarrjeve dhe bashkimit të ndërmarrjeve, të cilat prodhojnë dokumente ose deklarata sipas Rregullores (KE) nr. 1/2003, për të identifikuar dokumentet ose pjesët e dokumenteve të cilat ata i konsiderojnë se përmbajnë sekrete biznesi, ose të tjera informacione konfidenciale që i përkasin atyre, dhe të identifikojnë ndërmarrjet që këto dokumente duhet të konsiderohen si konfidenciale. Gjithashtu, Komisioni mund t'u kërkojë ndërmarrjeve ose bashkimit të ndërmarrjeve për të identifikuar çdo pjesë të deklaratës së kundërshtimeve, një përmbledhje çështjeje të hartuar sipas nenit 27 pika 4 të Rregullores (KE) nr. 1/2003 ose një vendim të miratuar nga Komisioni, i cili, në këndvështrimin e tyre, përmban sekrete biznesi.

Komisioni mund të vendosë një afat kohor brenda të cilit ndërmarrjet ose bashkimi i ndërmarrjeve duhet :

- a) të provojnë kërkesën e tyre për konfidencialitet sipas çdo dokumenti ose pjesë e dokumentit, deklaratë ose pjesë e deklaratës,
 - b) t'i sigurojnë Komisionit një version jokonfidencial të dokumenteve ose deklaratave në të cilat pasazhet konfidenciale janë fshirë,
 - c) të sigurojnë një përshkrim konciz të çdo pjese të informacionit të fshirë.
4. Nëse ndërmarrjet ose shoqatat e ndërmarrjeve dështojnë në përmbushjen e paragrafëve 2 dhe 3, Komisioni mund të supozojë se dokumentet ose deklaratat përkatëse nuk përmbajnë informacion konfidencial.

KREU VII DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17 **Afatet Kohore**

1. Në vendosjen e afateve kohore të parashikuara në nenin 3 pika 3, nenin 4 pika 3, nenin 6 pika 1, nenin 10 pika 2 dhe në nenin 16 pika 3, Komisioni ka parasysht si kohën e kërkuar për përgatitjen e deklaratave dhe urgjencën e rastit.
2. Afatet kohore referuar në nenin 6 pika 1, nenin 7 pika 1 dhe nenin 10 pika 2 janë të paktën katër javë. Megjithatë, për veprime të nisura me qëllim për miratimin e masave të përkohshme sipas nenit 8 të Rregullores (KE) nr. 1/2003, afati kohor mund të shkurtohet në një javë.
3. Afati kohor referuar në nenin 3 pika 3, nenin 4 pika 3 dhe nenin 16 pika 3 është të paktën 2 javë.
4. Kur është e përshtatshme, dhe mbi bazën e një kërkesë të arsyetuar të bërë përpara mbarimit të afatit kohor fillestar, afatet kohore mund të zgjaten.

Neni 18 **Shfuqizimet**

Rregulloret (KE) nr. 2842/98, (KE) nr. 2843/98 dhe (KE) nr. 3385/94 shfuqizohen.

Referencat për rregulloret e shfuqizuara interpretohen si referenca në këtë rregullore.

Neni 19
Dispozita kalimtare

Hapat proceduralë të ndërmarrë sipas Rregullores (KE) nr. 2842/98 dhe (KE) nr. 2843/98 vazhdojnë të kenë efekt për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 maj 2004.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjithë Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 7 prill 2004.

Për Komisionin

Mario Monti

Anëtar i Komisionit

[1] GZ L 1, 04.01.2003, fq. 1. Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr 411/2004 (GZ L 68, 06.03.2004, fq. 1).

[2] GZ L 354, 30.12.1998, fq. 18.

[3] GZ L 354, 30.12.1998, fq. 22.

[4] GZ L 377, 31.12.1994, fq. 28.

SHTOJCË

FORMULARI C

ANKIMI SIPAS NENIT 7 TË RREGULLORES (KE) NR. 1/2003

I. Informacioni, në lidhje me ankimuesin dhe atë ose ato ndërmarrje ose shoqatë ndërmarrjesh, me të cilat ka të bëjë ankimi

1. Jepni detaje të plota mbi identitetin e personit fizik ose juridik që parashtron ankimin. Kur ankimuesi është një ndërmarrje, identifikoni grupin e ndërmarrjeve të cilit i përket ndërmarrja dhe jep një përshkrim konciz të natyrës dhe fushës së aktiviteteve të tij të biznesit. Jepni një person kontakti (me numër telefoni, adresë postare dhe e-maili) nga i cili mund të merren shpjegime shtesë.
2. Identifikoni ndërmarrjet ose shoqatën e ndërmarrjeve, me sjelljen e të cilëve ka lidhje ankimi, duke përfshirë kur është e zbatueshme, të gjithë informacionin e disponueshëm mbi grupin e ndërmarrjeve të cilit i përket ndërmarrja ndaj së cilës është drejtuar ankimi, si dhe natyrën dhe fushën e aktiviteteve të biznesit të ndjekur nga ato. Tregoni pozicionin e ankimuesit ndaj ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve ndaj të cilëve drejtohet ankimi (p.sh. klient, konkurrent).

II. Detaje të shkeljeve dhe provave të pretenduara

3. Parashtroni me hollësi faktet mbi bazën e të cilave, sipas gjykimit tuaj, duket se ka shkelje të nenit 81 ose 82 të traktatit dhe/ose nenit 53 ose 54 të Marrëveshjes së ZEE. Tregoni në veçanti natyrën e produkteve (mallra ose shërbime) të ndikuara nga shkelja e pretenduar dhe shpjegoni, kur është e nevojshme, lidhjet tregtare që kanë të bëjnë me këto produkte. Paraqitni të gjitha detajet e disponueshme mbi marrëveshjet ose praktikatat e ndërmarrjes ose shoqatës së ndërmarrjeve me të cilat ka të bëjë ky ankim. Tregoni, për aq sa është e mundur, pozicionet relative të tregut të ndërmarrjeve me të cilat ka lidhje ankimi.
4. Paraqitni të gjithë dokumentacionin që dispononi që i përket ose ka lidhje të drejtpërdrejtë me faktet e parashtruara në ankim (p.sh. tekstet e marrëveshjeve, procesverbalet e negociatave ose mbledhjeve, kushtet e transaksioneve, dokumentet e biznesit, qarkoret, korrespondencën, shënimet e bisedave telefonike...). Deklaroni emrat dhe adresat e personave të aftë për të dëshmuar mbi faktet e parashtruara në ankim, dhe deklaro në mënyrë të veçantë emrat e personave të prekur nga shkelja e pretenduar. Paraqitni statistika ose të dhëna të tjera që ju zotëroni, të cilat kanë lidhje me faktet e parashtruara, veçanërisht kur ato tregojnë zhvillimet në treg (p.sh. informacioni në lidhje me çmimet dhe kahet e ndryshimit të çmimeve, barrierat e hyrjes në treg për tregtarët e rinj etj).
5. Parashtroni pikëpamjen tuaj mbi shtrirjen gjeografike të shkeljes së pretenduar dhe shpjegoni, kur nuk është e qartë, se në çfarë mase mund të jetë ndikuar nga sjellja me të cilën ka të bëjë ankimi, tregtia mes Shteteve Anëtare ose midis Komunitetit dhe një ose më tepër shteteve të EFTA-s që janë palë nënshkruese të Marrëveshjes së ZEE.

III. Vendimi që kërkohet nga Komisioni dhe interesi legjitim

6. Shpjegoni çfarë vendimi ose veprimi jeni duke kërkuar si pasojë e shqyrtimit të kryer nga Komisioni.
7. Parashtroni arsyet mbi të cilat ju pretendoni se keni një interes legjitim si ankimues sipas nenit 7 të Rregullores nr. 1/2003 (KE). Paraqisni në mënyrë të veçantë se si sjellja ndaj të cilës ankoheni ndikon mbi ju dhe shpjegoni se si në këndvështrimin tuaj, ndërhyrja nga Komisioni do të jetë e aftë të ndreqë shqetësimet e pretenduara.

IV. Shqyrtimi i çështjes nga autoritetet kombëtare të konkurrencës ose gjykatat kombëtare

8. Paraqitni informacion të plotë nëse ju i jeni drejtuar ndonjë autoriteti tjetër konkurrence dhe/ose nëse është ngritur padi përpara një gjykate kombëtare për të njëjtën çështje ose për një çështje shumë të përafërt. Në qoftë se po, paraqitni detaje të plota mbi autoritetin administrativ ose gjyqësor të kontaktuar dhe kërkesat tuaja ndaj këtij autoriteti.

Deklaratë se informacioni i dhënë në këtë formular dhe në shtojcat e tij është dhënë në mirëbesim të plotë.

Data dhe nënshkrimi.